



Prishtinë, 12 korrik 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1004_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 16 paragrafin 5 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_824_2016 të datës 23 qershor 2016 lëshuar shoqërisë "Air - Energy" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, në Lokacionin "Wind Park –KITKA" me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, komuna e Kamenicës; dhe
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim Final V_824_2016 të datës 23 qershor 2016 i Modifikuar me Vendimin V_985_2018 të datës 13 qershor 2018 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, Wind Park - KITKA, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, Komuna e Kamenicës, të datës 20.06.2018 të shoqërisë "Air -Energy" Sh.p.k., me adresë rruga "Isa Boletini" p.n. Gjilan, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 12 korrik 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "Air – Energy" SH.P.K. dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit Final V_824_2016 i datës 23 qershor 2016, i Modifikuar me Vendimin V_985_2018, për vazhdimin e ndërtimit të projektit Wind Park KITKA me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, Komuna e Kamenicës, edhe për 1 (një) vit, gjegjësisht deri **me 23 qershor 2019 për finalizimin e projektit.**

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 25.09.2013 nga shoqëria "Air - Energy" sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, në lokacionin "Wind Park - KITKA", komuna e Kamenicës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE pas konstatimit se apikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga ERA, me datë 27 dhjetor 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_604_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj



kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

- ZRRE me datë 07.12.2015 ka pranuar nga shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V_604_2013 të datës 27 dhjetor 2013, edhe për një afat shtesë ligjor, për të kompletuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 28 janar 2016 ka lëshuar vendimin nr. V_765-2016 për shtyrjen e vlefshmërisë së afatit të vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V_604_2013 të datës 27 dhjetor 2013, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me **27 qershor 2016**.
- ZRRE me datë 06.06.2016 nga shoqëria “Air - Energy” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA, në lokacionin “Wind Park - KITKA”, me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW komuna e Kamenicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga MMPH dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i ZRRE-së, me datë 23 qershor 2016 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V_824_2016 shoqërisë “Air - Energy” Sh.p.k, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Turbinat e Erës në Lokacionin “Wind Park –KITKA” me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, komuna e Kamenicës.
- ZRRE me datë 20 qershor 2018 nga shoqëria “Air - Energy” Sh.p.k, ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_824_2016 të datës 23 qershor 2016, të Modifikuar me Vendimin V_985_2018 për projektin Wind Park – KITKA , me kapacitet të instaluar prej 32.4 MW, ZK Hogoshtë, Poliçk dhe Velegllavë e Epërme, Komuna e Kamenicës, **për përfundimin e ndërtimit edhe për 1 (një) vit, gjegjësisht deri me 23 qershor 2019.**
- Shoqëria “Air–Energy” SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: nga kompania është duke punuar intezivisht në teren, janë kryer deri më tani më tepër se 80% të punëve teknike, janë përfunduar bazamentet për vendosjen e 9 turbinave sipas standardeve teknike dhe mjedisore, e tërë infrastruktura rrugore është finalizuar, janë kryer punimet në linjën e transmetimit të energjisë elektrike deri të nënstacioni i KOSTT(Berivojcë), është përfunduar edhe studimi i transportit të turbinave nga Durrësi deri në punishte.
- Shoqëria “Air –Energy” SH.P.K., ka sqaruar se janë në proces të sjelljes së të gjitha turbinave, ku deri ka mesi i muajit korrik të këtij viti, priten të arrijnë të gjitha turbinat dhe të finalizohen, dhe pas komisionimit nga KOSTT në aspektin teknik priten të fillojnë me prodhimin e energjisë elektrike. Poashtu kanë sqaruar se në projektin Wind Park – KITKA është projekti i parë që është duke u realizuar në Kosovë i kësaj madhësie, dhe sipas dinamikës së punimeve ky projekt gjatë këtij viti pritet të hyj në prodhim komercial.
- Shoqëria “Air –Energy” SH.P.K., ka sqaruar se në pajtim me legjislacionin një fuqi kanë bërë edhe kërkesën për modifikimin e Autorizimit Final , vetëm porsa i përket numrit të turbinave për shkak



të efijencës dhe reduktimit të numrit të turbinave dhe përshtatjes me rrafshnaltën e Kitkës, ku në mbledhjen e Bordit të ZRRE-së, të mbajtur me 13 qershor 2018 është aprovuar kërkesa vetëm për numrin e turbinave pa u ndryshuar kapaciteti total prej 32.4 MW, dhe projekti tanimë është në harmoni të plotë me Rregullën e Autorizimit të ZRRE.

- *Arsyeja e shtyrjes së afatit për periudhën një (1) vjeçare është që projekti KITKA të jetë në harmoni me legjislacionin në fuqi, dhe të ketë hapësirë ligjore të veprimit në realizimin e këtij projekti pasi që, kapaciteti është më i madhi i ndërtuar deri më tani përmes Procedurës së Autorizimit, specifikat e terrenit dhe specifikat e projektit, na kanë detyruar që të jemi në të kujdesshëm pasi që vlera e projektit është mjaft e madhe dhe rreziqet na është dashur ti kemi parasysh, dhe të gjitha këto na kanë shkaktuar vonesa në përfundimin e këtij projekti deri më tani, e për të cilin kanë kërkuar mundësinë e shtyrjes nga ZRRE-ja, për finalizimin e këtij projekti.*
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës së shoqërisë "Air Energy" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, Wind Park - KITKA me kapacitetit të instaluar prej 32.4 MW, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se kërkesa është e bazuar pasi që ndërtimin i kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës është mjaft e vështirë për shkak të terreneve, kushteve klimatike dhe kompleksitetit të këtyre projekteve, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V_824_2016 i datës 23 qershor 2016 i Modifikuar me Vendimin V_985_2016, do të vlen deri me datë **23 qershor 2019** sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.


III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së





Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Kamenicës,
- Sekretarit të MMPH-së, dhe
- Arkivit të Rregullatorit